

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	BE: Varrimi i Mlladiqit nuk ishte me nderime shtetërore
ADRESA	https://www.koha.net/rajon/be-varrimi-i-mlldiqit-nuk-ishte-me-nderime-shteterore
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:53:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	7 shtator 2026, 14:31:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	552826a4fb7db5cc41babe85915269c7e3ba049b33a299e3023253b3fa693a20
TEKSTI	714e9578d11faf58d4fcd4e449a3cf1a19298731bd225db69515e9c8029bb4c0
PAMJA	9ca14533349bc24174eb41cb5e3dcaac4a3ae0dcaaaa98713ebbb1da8dc8299f7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	26611a2201dc69ceef22d034886a86a57e873e6d18a2ed51c37f31692ad981c1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/26611a2201dc69ceef22d034886a86a57e873e6d18a2ed51c37f31692ad981c1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

RAJON

BE: Varrimi i Mlladiqit nuk ishte me nderime shtetërore



Nga: Augustin Palokaj

7 shtator 2026 16:31

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Bashkimi Evropian në ditën e varrimit të kriminelit Ratko Mlladiq ka përsëritur thirrjet që të mos ketë glorifikim të krimineleve të luftës dhe mohim të gjenocidit, por të gjithë të fokusohen në nderimin e viktimave dhe në pajtimin në rajon.

Por në reagimin e Komisionit Evropian, e habitshme ishte pohimi se ata këtë varrim nuk e shohin si një funeral me nderime shtetërore. Këtë e tha Paula Pinho, zëdhënëse e Komisionit Evropian.

“Qëndrimi ynë është shumë i qartë. Nuk ka vend për glorifikimin e kriminelëve të luftës apo të atyre që mohojnë gjenocidin, ose të atyre që bien ndesh me vlerat më themelore evropiane. Fakti është se ne kishim dëgjuar se ishte planifikuar një varrim me nderime shtetërore dhe kjo nuk ka ndodhur. Kështu që, ju lë juve të gjykonit për rëndësinë e qëndrimit tonë për këtë çështje”, ka thënë zëdhënësjja Pinho.

Gazetarët insistuan në konferencën për shtyp të hënën, që të sqarohet se si kanë ardhur në konkludim se ky nuk ishte varrim me nderime shtetërore kur nderimet i bëri ushtria e shtetit, komandant i të cilëve është presidenti i shtetit dhe aty ishin edhe ministra nga qeveria. Po ashtu gazetarët pyeten se a do të ketë pasoja për këtë sjellje të Serbisë. Por përgjigja ishte shumë e paqartë.

“Siç thashë, ne e kemi bërë shumë, shumë të qartë qëndrimin tonë edhe për autoritetet serbe. Se çfarë do të jenë hapat pasues, dhe nëse do të ketë të tillë, do ta shohim”, ka thënë ajo.

Jozyrtarisht në BE kanë thënë se në kontaktet e ditëve të fundit me zyrtarët e Serbisë u është bërë e qartë se do të ketë pasoja për sjelljen e tyre ndaj kriminelit Mlladiq, por nuk thanë se cilat do të jenë pasojat. Ndër to nuk përjashtohet as mundësia e anulimit të vizitës së Presidentes së Komisionit Evropian Ursula von der Leyen në Serbi muajin e ardhshëm, kur është planifikuar një turne i saj në vendet e rajonit.

Arbëri.

14 shkolla në proces të mbylljes, shkaku i rënies së numrit të nxënësve

Kronikë.

Vëzhgimi me dronë, Policia në Gjakovë për 5 ditë pezulloi 152 patentë shoferë dhe shqiptoi 774 gjoba

Arbëri.

Çitaku: Kushtetuta nuk është meny prej së cilës zgjedh çka të pëlqen

Futboll.

Galtasaray fiton me rezultat minimal në shtëpi

Shtojca për Kulturë.

Xhafa: Rezistenca e popullit shqiptar – burim i pashtershëm frymëzimi

Futboll.

Krasniqi asiston dy herë në fitoren 5:0 të Amedsportit

Artikuj të ngjashëm



Rajon • 7 sht 2026

Krimineli i luftës Mlladiq varroset si hero në Serbi, pavarësisht paralajmërimeve të BE-së



Arbëri • 7 sht 2026

Krimineli Mlladiq varroset me nderime shtetërore e ushtarake. BE: S'ishin nderime shtetërore



Rajon • 8 sht 2026

Vuçiçi komenton deklaratat e Von der Leyenit dhe Costas për funeralin e kriminelit të luftës Mlladiq



Arbëri • 8 sht 2026

BE-ja i quan shokuese pamjet nga varrimi i Mlladiqit, Kurti akuzon Serbinë për adhurim të gjenocidit



Rajon • 8 sht 2026

Deklarohen edhe Costa dhe Von der Leyen: Pamjet nga funerali i Mlladiqit ishin shokuese

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografite, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohej kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzimet për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

